



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 843/1 Prot.

Tiranë, më 10 / 07 / 2020

V E N D I M

Nr. 67, Datë 10 / 07 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 60 Regj., datë 26.06.2020, të D. Rr kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Shkodër dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se, në vitin 1973 ka filluar së pari punë në ish- Kooperativën Bujqësore Bushat, duke cituar se: *“Kam punuar një vit në këtë ish-Kooperativë dhe vitet e tjera në ndërmarrje shtetërore, pa ndërprerje deri në vitin 1995. Më pas kam punuar në firma private dhe në KESH sh.a deri në mbushjen e moshës së pensionit. Në llogaritjen e pensionit më janë përfshirë vitet ose periudhat e sigurimit si më poshtë:*

- *Periudha nga data 23.04.1974 deri më datë 06.11.1974. (Viti 1993 nuk më është njohur).*
- *Periudha nga data 27.12.1974 deri më datë 06.01.1978 është përfshirë në llogaritjen e pensionit.*
- *Periudha nga data 02.03.1978 deri më datë 14.04.1990 është përfshirë në llogaritjen e pensionit.*
- *Periudha nga data 17.04.1990 deri më datë 31.12.1993 është përfshirë në llogaritjen e pensionit, ndërsa vitet 1994, 1995 vite të cilat i kam të vërtetuara me dokumente dhe Librezë Pune nuk janë përfshirë në llogaritjen e pensionit.*
- *Periudha nga data 01.01.2006 deri më datë 30.04.2007 është përfshirë në llogaritjen e pensionit.*

- *Periudha nga data 01.07.2007 deri më datë 08.05.2008 është përfshirë në llogaritjen e pensionit.*
- *Periudha nga data 01.09.2009 deri më datë 30.06.2011 është përfshirë në llogaritjen e pensionit.*
- *Periudhat: 21.02.2017-23.03.2017; 01.07.2017-31.08.2017; 16.09.2018-22.11.2018; 30.03.2019-20.05.2019 janë përfshirë në llogaritjen e pensionit¹.*

Në vijim të sa më sipër, subjekti ankues, ka pretenduar diskriminim nga ana e DRSSH Shkodër dhe ISSH lidhur me mosnjohjen si periudhë e sigurimit shoqëror për efekt të përlllogaritjes së pensionit, të periudhës nga data 01.01.1994-30.04.1995, të cilën ai dokumenton se ka qenë punonjës i ish - Ndërmarrjes Elektrike Shkodër.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, njohjen e viteve të punës¹ dhe përfshirjen e tyre në përlllogaritjen e pensionit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD, konstatohet se:

¹ Periudha nga data 01.01.1994 deri më datë 30.04.1995.

- Nëpërmjet shkresës me nr.9304 prot., datë 19.09.2019, D. Rr ka paraqitur ankesë pranë DRSSH Shkodër, në të cilën ka kërkuar që për efekt të përlllogaritjes së pensionit t'i njihej si periudhë sigurimi dhe periudha nga data 01.01.1994 deri më datë 30.04.1995, gjatë së cilës ai ka paraqitur dokumentacion se ka qenë i punësuar pranë ish-Ndërmarrjes Elektrike Shkodër.
- Me Vendimin nr.227, datë 26.09.2019, Komisioni Rajonal i Ankimit (KRA) pranë DRSSH Shkodër ka vendosur të rrëzojë kërkesën ankimore të D.Rr me arsyetimin se: *“Në përlllogaritjen e pensionit, nga e gjithë vjetërsia nuk ju është marrë në konsideratë periudha 01.01.1994-30.04.1995 pranë ish-Ndërmarrjes Elektrike Shkodër, pasi sipas vërtetimit me nr.2773 prot., datë 09.07.2019, lëshuar nga DRSSH Shkodër, emri juaj nuk figuron në listëpagesat që disponojmë për këtë subjekt. Në mbështetje të neneve 9,13,15, 58, 91, pika 3 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, citohet: “Koha pas hyrjes në fuqitë këtij ligji njihet si periudhë e sigurimit shoqëror vetëm kur është derdhur kontribut sipas këtij ligji”. Pra, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore konsiderohet periudhë sigurimi vetëm periudha për të cilën janë paguar kontributet shoqërore”.*
- Me datë 04.12.2019 ankuesi ka kundërshtuar Vendimin e KRA pranë DRSSH Shkodër në Komisionin Qendror të Ankimit pranë ISSH.
- Pas shqyrtimit të ankesës, nëpërmjet Vendimit nr.1921, datë 15.01.2020, Komisioni Qendror i Ankimit pranë ISSH ka vendosur të rrëzojë kërkesën e tij² dhe të lërë në fuqi Vendimin nr.227, datë 26.09.2019 të KRA pranë DRSSH Shkodër.

Lidhur me pretendimet e subjektit ankues, për kundërshtimin dhe mosdakortësinë e tij me vendimin e Komisionit Qendror të Ankimit pranë ISSH; Komisioneri informon subjektin ankues, se vendimi i këtij Komisioni kundërshtohet gjyqësisht, pasi Gjykata jep vendimin përfundimtar lidhur me këtë çështje. Rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtij organi nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 86 “Ankimimi”, ka përcaktuar se:

“1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Ankimi në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel;

2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është Përfundimtar”.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të*

² Me të njëjtin arsyetim ligjor si KRA pranë DRSSH Shkodër.

mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Neni 42 i Kushtetutës vendos standarde kushtetuese si për gjykatat, ashtu dhe për organet e administratës publike. Pika 2 e po këtij neni, sanksionon se kushdo mund t’i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Kjo dispozitë, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cënim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar dhe rastin kur cënimi vjen dhe nga një akt administrativ i tillë.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, dhe në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë³”, i ndryshuar; t’i drejtoheni Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për të kundërshtuar vendimin e Komisionit Qendror të Ankimit pranë ISSH.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues D. Rr, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Shërbime
Shkaku: Mosha
Vendim mospranimi

³ Neni 86, pika 3 e tij.